



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Prot. 239

Tiranë, 24 mars 2022

Vendim nr. 15, datë 23 mars 2022

Për caktimin e detyrave dhe organizimin e punës të Komisionit organizativ për festimin e 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave

Në zbatim të vendimit nr. 14 datë 23 mars 2022 të Kryesisë Për ngritjen e komitetit të nderit dhe të komisionit organizativ për festimin e 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 23 mars 2022, Kryesia

Vendosi:

1. Për përgatitjen dhe botimin e librit jubilar kushtuar 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave caktohet prof. asoc. dr. Marenglen Kasmí. Përgatitja të bëhet nën drejtimin e akad. Vasil S. Tole.
2. Te realizohet një dokumentar televiziv në bashkëpunim me RTSH. Për skenarin ngarkohet sekretari shkencor.
3. Për përgatitjen për botim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për Akademinë e Shkencave, ngarkohen: përgjegjësjja e sektorit të botimeve, juristja e redaktorja shkencore. Përgatitja të bëhet nën drejtimin e sekretarit shkencor.
4. Ngarkohet kancelari për përditësimin e panelit të fotove të anëtarëve të Asamblesë (akademikë, akademikë të asociuar) dhe të anëtarëve të Akademisë (anëtarë të jashtëm, anëtarë nderi).
5. Për përditësimin dhe plotësimet në *Librin e Artë të Albanologjisë* ngarkohen sekretari shkencor dhe kancelari.

6. Për përgatitjen e propozimeve për dekorim dhe komunikimin zyrtar me institucionet përkatëse ngarkohet zëvendëskryetari.
7. Për përgatitjen e shenjave të nderimit të 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave (spilë metalike, ID të personalizuar për ngjarjen, bllok, çantë, stilolaps, certifikatë pjesëmarrjeje etj.) ngarkohen sekretari shkencor, kancelari dhe sektori i botimeve.
8. Personat e ngarkuar nominalisht me këtë akt për kryerje detyrash specifike për festimin e 50-vjetorit të propozojnë brenda muajit mars shtimin e bashkëpunëtorëve dhe të hartojnë preventivat përkatës.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINÛSHI


KRYETAR

